

E-KOMUNAT

një hap drejt pjesëmarrjes së plotë qytetare



Hyrje

Në Prill të vitit 2017, Iniciativa e Re Sociale – NSI filloi një projekt pilot “Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe llogaridhënies në qeverisjen lokale në veri të Kosovës”. Qëllimi ishte të vlerësohej niveli aktual i respektimit të komunave lokale ndaj parimeve të pjesëmarrjes dhe përgjegjësisë së qytetarëve sipas kornizës ligjore të Kosovës.¹ Për më tepër, qëllimi i projektit ishte të identifikonte shembuj të mirë dhe të zbulonte zbatueshmërinë e tyre brenda kontekstit lokal.² Kjo rezultoi me një sërë rekomandimesh dhe veprimesh lidhur me ndihmën teknike që forcuar qeveritë lokale për të krijuar mekanizma inovativ për bashkëveprim me qytetarët.

Pas hulumtimit lidhur me mendimet dhe qëndrimet e qytetarëve, analizimit të nevojave të tyre, por gjithashtu edhe analizimit të shembujve të mirë nga rajoni kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, NSI lansoi platformën virtuale E-Zveçan në nëntor të vitit 2017 (www.ezvecan.com).

Pas zbatimit të suksesshëm të pilot projektit, NSI, me mbështetjen financiare të PAX dhe OSBE, në fillim të vitit 2018 filloi një proces për krijimin e platformave shtesë virtuale, E-komunat, në tri komunat e mbetura në veri të Kosovës (Mitrovica e Veriut, Leposaviqi dhe Zubin Potoku). Në nëntor të vitit 2018, u hapën tre platforma të reja në internet, E-komunat (www.esevenamitrovica.com, www.eleposavic.com, www.ezubinpotok.com).

E-komunat janë platforma unike në internet me qëllimin kryesor të ofrojnë informacione për qytetarët në lidhje me strukturën dhe funksionimin e komunave të tyre. Kjo përfshin informimin e qytetarëve për ngjarjet dhe lajmet në nivelin lokal, i siguron shoqërisë civile dhe qytetarëve çasje në dokumentet publike, por gjithashtu mundëson qytetarëve pjesëmarrje përmes mekanizmave të disponueshëm Sistemi 48h dhe Pyetni Kryetarin e Komunës. Përmes mekanizmit System 48h, qytetarët mund të raportojnë një problem në komunën e tyre. Me këtë mekanizëm, qytetarët mund të zgjedhin llojin e problemit, të japin përshkrimin e problemit dhe vendndodhjen e tij, dhe të bashkëngjitin foto. Duke siguruar informacionin e kontaktit, qytetarët marrin përgjigje direkt brenda 48 orëve. Të gjitha paraqitjet dhe përgjigjet arkivohen

¹ Milovanović, Dina, ‘Is Your Municipality Truly Yours? – Assessment of local governments’ adherence to principles of citizen participation in north Kosovo’, NSI, 2017; <http://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2017/11/Is-your-municipality-is-truly-yours-1.pdf>

² NSI, ‘Innovative Approaches in Citizen Participation: Good Practices’, 2017; http://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2017/11/Good-Practices-report_final-draft.pdf

në faqet e internetit të E-komunave. Përmes mekanizmit Pyetni Kryetarin e Komunës, qytetarët mund të komunikojnë me kryetarin e tyre përmes platformës në internet. Ky mekanizëm i lejon qytetarët t'i bëjnë pyetje drejtpërdrejtë kryetarit. Nëse pyetja është brenda kompetencës së kryetarit, ata marrin një përgjigje përmes postës elektronike. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet janë në dispozicion në faqet e internetit të E-komunave.

Nga fillimi i vitit 2020, që të katër platformat virtuale janë gjithashtu në dispozicion në gjuhën shqipe (më parë ishin vetëm në serbisht), në sajë të mbështetjes së Zyrës së Komisionerit të Gjuhëve dhe Fondit Evropian për Demokraci (EED).

Në Mars 2020, faqja e informacionit Covid-19 u shtua në platforma për të informuar qytetarët në lidhje me situatën në lidhje me pandeminë. Në këtë periudhë, e-komunat u përdorën për konsultime publike virtuale të organizuara nga komunat nën Programin e Zhvillimit Gjithëpërfshirës të zbatuar nga UN-Habitat, PAX dhe Community Building Mitrovica.

Që nga themelimi i tyre deri më sot, E-komunat kanë ndjekur trendin e rritjes, derisa komunat masin numrin e përdoruesve si dhe numrin e përdoruesve të Sistemit 48h dhe mekanizmat Pyetni Kryetarin e Komunës.




E-OPŠTINA
ZVEČAN
E-KOMUNA
E-ZVEČANIT




Zvečan

Platforma virtuale E-Zvečan ishte e para që u krijua dhe zyrtarisht filloi të punojë më 28 nëntor 2017. Platforma E-Zvečan është vizituar nga 18831 përdorues unikë me më shumë se 34655 seanca që nga themelimi i saj në fund të vitit 2020. Kur krahasojmë sipas viteve: Në periudhën nëntor 2017 – tetor 2018 E-Zvečan u vizitua nga 5431 përdorues me 10 726 seanca, në periudhën nëntor 2018 – tetor 2019 platforma kishte 8142 vizitorë dhe 13057 seanca, dhe në periudhën nëntor 2019 – tetor 2020 platforma kishte 5260 përdorues dhe 9949 seanca, i cili është numri optimal i përdoruesve të E-opština Zvečan, duke pasur parasysh madhësinë e komunës dhe numrin e qytetarëve të saj.



Users
18,794

New Users
18,831




Sessions
34,655

Duke përdorur E-Zvečan, qytetarët i dërguan kryetarit të Komunës 39 pyetje përmes mekanizmit Pyet Kryetarin e Komunës, nga të cilat 24 morrën përgjigje, ndërsa 15 nuk morrën përgjigje sepse pyetjet nuk ishin nën kompetencat e kryetarit. Komuna e Zvečanit u është përgjigjur gjithsej 41 kërkesave të dërguara nga qytetarët përmes Sistemit 48h.

Komuna e Zvečanit dikur kreu një konsultë publike me qytetarët duke përdorur platformën E-Zvečan, arsyeja ishte [rindërtimi dhe përshtatja e sallës së prodhimit për nevojat e zjarrfikësve në Zvečan.](#)

Mitrovica Veriore

Platforma e internetit E-Mitrovica Veriore ka qenë zyrtarisht funksionale që nga 28 nëntori 2018. Kjo platformë është vizituar nga 8567 përdorues të cilët kanë pasur 11859 seanca që nga themelimi i saj në fund të 2020. Në periudhën nëntor 2018 – tetor 2019 platforma E-Mitrovica Veriore kishte 1530 vizitorë dhe 2338 seanca, në periudhën nëntor 2019 – tetor 2020 platforma kishte 6010 përdorues dhe 8064 seanca.



Duke përdorur E- Mitrovica Veriore, qytetarët i dërguan kryetarit të Komunës 23 pyetje përmes mekanizmit Pyet Kryetarit e Komunës, nga të cilat 13 morrën përgjigje, ndërsa 10 nuk morrën përgjigje sepse pyetjet nuk ishin nën kompetencat e kryetarit. Komuna e Mitrovicës Veriore u është përgjigjur gjithsej 7 kërkesave të dërguara nga qytetarët përmes Sistemit 48h.

Komuna e Mitrovicës së Veriut ende nuk e ka përdorur E-Mitrovica Veriore për konsultime publike me qytetarë.




E-OPŠTINA
LEPOSAVIĆ
E-KOMUNA
LEPOSAVIĆ




Leposaviq

Platforma virtuale E-Leposaviq ka qenë zyrtarisht funksionale që nga 28 nëntori 2018. Kjo platformë është vizituar nga 8330 përdorues të cilët kanë pasur 14876 seanca që nga themelimi i saj. Në periudhën nëntor 2018 – tetor 2019 platforma E-Leposaviq kishte 1903 vizitorë dhe 3281 seanca, në periudhën nëntor 2019 – tetor 2020 platforma kishte 5903 përdorues dhe 10182 seanca.



Users
8.2K

New Users
8.330




Sessions
14,876

Duke përdorur platformën E-Leposaviq, qytetarët i dërguan kryetarit të komunës 20 pyetje duke përdorur mekanizmin Pyetni Kryetarin e Komunës, nga të cilat 10 morrën përgjigje, ndërsa 10 nuk morrën përgjigje sepse pyetjet nuk ishin nën kompetencën e kryetarit. Komuna e Leposaviqit i është përgjigjur gjithsej 1 kërkesës së dërguar nga qytetarët përmes Sistemit 48h.

E-Leposaviq u përdor për qëllimin e hartimit të projekt propozimit përfundimtar: Rehabilitimi dhe përshtatja e objektit dhe hapësirës publike për nevojat e organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, dhe themelimi i [Qendrës për testimin e përdorimit të mundshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit në rajon](#). Kjo platformë virtuale u përdor gjithashtu për qëllimet e zhvillimit të [Planit të Pjesëmarrjes Qytetare](#).

Zubin Potok

Platforma virtuale E-Zubin Potok ka qenë zyrtarisht funksionale që nga 28 nëntori 2018. Kjo platformë është vizituar nga 5675 përdorues të cilët kanë pasur 8162 seanca që nga themelimi i saj në fund të vitit 2020. Në periudhën nëntor 2018 – tetor 2019 platforma E-Zubin Potok kishte 1309 përdorues dhe 1890 seanca, në periudhën nëntor 2019 – tetor 2020 platforma kishte 3985 përdorues dhe 5666 seanca.



Duke përdorur E-Zubin Potok, qytetarët i dërguan kryetarit të kësaj komune 12 pyetje, nga të cilat në 4 morrën përgjigje, ndërsa 8 jo sepse pyetjet nuk ishin nën kompetencat e kryetarit. Duke përdorur sistemin 48 orë, qytetarët dërguan 5 kërkesa në komunën e Zubin Potokut.

Komuna e Zubin Potokut e përdori E-Zubin Potok për konsultime publike me qytetarë në dy raste. E-Zubin Potok u përdor për konsultime në lidhje me ndërtimin e [rrugëve lokale në fshatrat Crepulja dhe Previja](#), dhe për qëllimet e zhvillimit të [Planit të Pjesëmarrjes së Qytetarëve](#).

Covid-19 Faqja Informative

Në fillim të Prillit 2020, NSI krijoi faqen e informacionit COVID-19 si pjesë e platformave të E-komunave. Qëllimi i kësaj faqe është të mbledhë në një vend informacione të rëndësishme dhe të besueshme në lidhje me COVID-19, statistikën, numrat e rëndësishëm të telefonit në nivelin shtetëror dhe komunal, si dhe t'u sigurojë qytetarëve linke të dobishme gjatë pandemisë së koronavirusit.

Vegzat e faqeve: [E-Zveçan Covid-19 faqja informative](#); [E-Mitrovica Veriore Covid-19 faqja informative](#); [E-Leposaviq Covid-19 faqja informative](#); [E-Zubin Potok Covid-19 faqja informative](#).

Nga 77 përgjigje të marra nga pyetësi online i kryer nga NSI në nëntor 2020, 62.3% e të anketuarve u përgjigjën se E-komunit i ndihmuan ata për të marrë informacione gjatë pandemisë.

Rezultatet e pyetësorit

Në nëntor 2020, NSI zhvilloi një pyetësor në internet për të mbledhur qëndrimet e qytetarëve për përdorimin e faqeve E-komunale dhe për të marrë rekomandimet e qytetarëve për përmirësimin e tyre. Pyetësi përfshinte qytetarë të katër komunave në veri të Kosovës.

Ne ju tregojmë rezultatet më të rëndësishme të pyetësorit:


1. Rishikimi i pyetësorit:

Të dhënat themelore:


- Gjithsej 101 përgjigje
- Gjinia: 55.4% meshkuj; 44.6% femra
- Moshë: 46.5% ndërmjet moshës 26-35; 26.7% ndërmjet moshës 36-55; 24.8% ndërmjet moshës 18-25;
- Komuna nga vijnë: 46.5% Mitrovica e Veriut; 21,8% Leposaviq; 16,8% Zveçan; 7,9% Zubin

Gjetjet kryesore:


1) A jeni dhe sa shpesh jeni të informuar për punën e komunave në Veri të Kosovës?




2) Si i merrni informacionet në lidhje me punën e komunës tuaj?




3) A e dini se ekzistojnë uebfaqet (platformat elektronike) të katër komunave në veri të Kosovës – E-komunat?




4) Sa shpesh i vizitoni uebfaqet e E-komunave?




5) Çfarë kërkon më shumë në E-komunat?




6) A mendoni se informacioni i ofruar në E-komunat është i dobishëm për të kuptuar përparësitë, politikat dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale?




7) A mendoni se E-komunat ndihmojnë qeveritë lokale të jenë më transparente dhe të përgjegjshme para qytetarëve?




8) A ju kanë ndihmuar E-komunat për të marrë informacione gjatë pandemisë?



9) A i keni dërguar ndonjëherë një kërkesë komunës duke përdorur mekanizmin e Sistemit 48h?



10) Nëse po, a morrët përgjigje brenda afatit prej 48 orësh?



2. Sugjerimet e përdoruesve për përmirësimet e mundshme të E-komunave:

"Pyetjet për komunat mund të shihen nga të tjerët, për të rritur përgjegjësinë e komunave. Mund të ketë gjithashtu një forum në të cilin diskutohen disa tema, për të mbajtur të informuar këshilltarët."

"Gjithçka për punën e sektorëve të veçantë të komunës; për të përfunduar punë e shërbime në mënyrë elektronike pa pasur nevojë të shkohet në komunë..."

"Më shumë dokumente me rëndësi publike."

"Projektet e infrastrukturës si dhe sugjerimet e qytetarëve se çfarë të bëjnë në vetëqeverisjen lokale, pa shkuar në asamble."

"Një pjesë ku qytetarët mund të propozojnë idetë dhe propozimet e tyre për rregullimin e komunës së tyre."

"Projektet për vitin e ardhshëm me një tregues të afateve për përfundimin e punimeve dhe numrin e fondeve të dhëna për ato qëllime."

"Informacion mbi tenderët, të shpallur dhe të fituar."

"Mundësia e kërkesës për nxjerrje të dokumentacionit në mënyrë virtuale."

"Dokumentet e miratuara në asamble."

"Vende të lira pune."

"Intervista me zyrtarë komunalë."

Lidhur me NSI

Iniciativa e Re Sociale – NSI është një organizatë që punon në Kosovë, por gjithashtu bashkëpunon me palët kryesore të interesit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, për të ndikuar përfundimisht në përfshirjen, ndërtimin e besimit, proceset e demokratizimit dhe qeverisje të mirë në Kosovë. Ndërsa e bën këtë, NSI ndjek vizionin e saj për një shoqërie gjithëpërfshirëse të ndërtuar mbi besimin dhe vlerësimin mes komuniteteve, ku qytetarë nga të gjitha grupet etnike marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe qeverisje. NSI përpiket të ketë ndikim dhe të sjellë ndryshime duke fuqizuar zonat elektorale, dhe komunitet jo-shumicë bazuar përshtirë gjithë Kosovën, për pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe institucionale të Kosovës dhe duke rritur besimin midis komuniteteve. NSI beson se ndryshimi i pozitës së komunitetit serb të Kosovës dhe ndërveprimi me komunitetin shumicë është një nga kontribuesit kryesorë në gjithëpërfshirjen dhe demokratizimin e shoqërisë kosovare.

VIZIONI

Vizioni i Iniciativës së Re Sociale është të krijohet një shoqëri gjithëpërfshirëse e ndërtuar mbi besimin dhe vlerësimin mes komuniteteve në Kosovë dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve nga grupe të ndryshme etnike / komunitete jo-shumicë.

MISIONI

NSI është një organizatë e shoqërisë civile që fuqizon komunitetet jo-shumicë për pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe institucionale të Kosovës dhe rrit besimin mes komuniteteve duke mbështetur ballafaqimin me të kaluarën dhe normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

Falënderimet

E-Komunat u bë e mundur përmes mbështetjes së:

PAX është një organizatë paqësore Hollandeze dhe punon me qytetarë dhe partnerë të përkushtuar për të mbrojtur civilët kundër akteve të luftës, për t'i dhënë fund dhunës së armatosur dhe për të ndërtuar paqen e drejtë. PAX operon në mënyrë të pavarur nga interesat politike. Që nga viti 2017, PAX ka partneritet me UN-Habitat dhe Community Building Mitrovica (CBM) nën Programin e Zhvillimit i Gjithëpërfshirës, mbështetur nga SIDA. PAX ka mbështetur NSI përmes projektit "Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe llogaridhënies në qeveritë lokale në veri të Kosovës".

Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet palët e interesuara qendrore dhe lokale për të përmirësuar rolin e tyre mbikëqyrës mbi drejtuesit dhe ofron këshilla se si të rritet transparenca, komunikimi dhe pjesëmarrja e publikut, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë. OSBE ka mbështetur NSI përmes projektit "Avancimi i rolit të OShC-ve, grave dhe burrave të rinj udhëheqës të ardhshëm në vendimmarrje dhe jetën publike (faza II), Aktiviteti 1.1. - Mbështetja e Inovacionit në Pjesëmarrjen Publike".

Zyra e Komisionerit të Gjuhëve (OLC) është e mandatuara të mbikëqyrë zbatimin e ligjit për gjuhët, punon me institucionet për të përmirësuar zbatimin e ligjit dhe për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën për përdorimin e gjuhës për të gjitha komunitetet në Kosovë. OLC ka mbështetur NSI përmes projektit "Komuna ime flet gjuhën time" në 2019.

Fondi Evropian për Demokraci (EED) është një organizatë e pavarur, krijuese e granteve që mbështet njerëzit që përpiqen për demokraci në Fqinjësinë Evropiane - Partneritetin Lindor, Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.

Fondi i Vëllezërve Rockefeller (RBF) mbështet ndryshimin shoqëror që kontribuon në një botë më të drejtë, të qëndrueshme dhe paqësore.



@newsocialinitiative



@NSIMitrovica



@nsimitrovica



Čika Jovina V/117, North Mitrovica



www.newsocialinitiative.org



office@newsocialinitiative.org

